

DEKRET
Nr. 201, datë 8.4.2026

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Kalorës i Urdhrit të Lisit Akademik”
zonjës Klarita Novrus Gërxhani**

“Në vlerësim të meritave në fushën e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies akademike, kryesisht në Holandë, si dhe të kontributeve të dalluara veçanërisht përmes punimeve të saj me fokus socio-ekonomik, fiskalitetin dhe evolucionin e tregjeve të punës krahasimisht me impaktin në to të përfaqësimit gjinor, duke u vlerësuar si një nga penat dhe zërat më premtues të fushës së saj në gjirin e Diasporës Shqiptare”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj